

V E N D I M
Nr.403,datë 11.6.2001

PËR RRYTJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE

(Ndryshuar me VKM nr .457, datë 28.6.2001)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror” dhe të nenit 1 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Minster i Punës dhe i Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të ushtarakëve, të caktuara sipas ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, me datë fillimi deri më 30.6.2001, përfshirë edhe kjo datë, rriten në masën 8 për qind.

2. Pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr. 8455, datë 4.2.1999, me datë fillimi deri më 30.6.2001, përfshirë edhe kjo datë, rriten në masën 8 për qind.

3. Efektet financiare për rritjen e përfitimeve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi janë parashikuar në buxhetin e vitit 2001 për sigurimin suplementar të ushtarakëve dhe llogaritjen në shumën:

35.483.000 (tridjetë e pesë milionë e katërqind e tëdhjetë e tre mijë) lekë për pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të ushtarakëve;

576.000 (pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, për pensionet familjare, të familjeve në ngarkim të pilotëve që kanë humbur jetën gjatë fluturimit në përmbushje të detyrës.

4. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Banka e Kursimeve dhe Albapost, sh.a. për zbatimin e këtij vendimi dhe nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga 1.7.2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta